

BRIF MUJOR

Nëntor 2016

Monitorimi i qeverisjes të rritjes në fushën e drejtësisë nga Strategjia për Evropën Juglindore 2020 (JuDGMeNT)

Pasqyra mujore publikohet në kuadër të Projektit “Monitorimi i qeverisjes të rritjes në fushën e drejtësisë nga Strategjia për EJK 2020 (JuDGMeNT)”, të cilin e zbaton Instituti për Politikë Evropiane, me mbështetje financiare të Këshillit Rajonal për Bashkëpunim. Qëllimi kryesor i Projektit është vendosja e mekanizmit të strukturuar nga organizatat qytetare për monitorimin e përmbushjes së masave/instrumenteve/prioriteteve nga dimensionimi *Drejtësi*, konform Strategjisë së EJK 2020. Këto masa janë:

P.1. Përmirësimi i efikasitetit dhe kompetencës: pasqyra e cilësisë, efikasitetit dhe kompetencës të gjyqtarëve dhe gjykatave;

P.2. Përmirësimi i bashkëpunimit gjyqësor sa i përket qasjes së lirë deri te informacionet, zbatimi i ekzekutimeve ndërkufitare dhe procedurave ndërkufitare sa i përket falimentimit, transferimit dhe bashkimit;

P.3. Mbështetje të zgjidhjes alternative të kontesteve (ZAK): Inkorporimi ose përmirësimi i kornizës ligjore për ZAK dhe ofrimi i bashkëpunimit përkatës juridik dhe institucional me sistemin gjyqësor dhe me sistemin e zbatimit.

Për më shumë informacione për Projektin vizitoni linkun në vijim: http://www.epi.org.mk/newsDetail_mk.php?nwsid=131.

Cilësia, kompetenca dhe efikasiteti i gjyqtarëve dhe gjyqësorit

Akademia për Gjyqtarë dhe Prokurorë Publikë

Akoma nuk ka informacione lidhur me fillimin e ligjëratave të gjeneratës së gjashtë të kandidatëve për gjyqtarë dhe prokurorë publikë në Akademinë për Gjyqtarë dhe Prokurorë Publikë “Pavell Shatev” që ka të bëjë me procedurat të cilat zhvillohen para Gjykatës Administrative dhe Gjykatës së Lartë Administrative, në lidhje me përzgjedhjen e dëgjuesve të trajnimit fillestar.

Përndryshe, gjatë muajit nëntor, Akademia e shënoi funksionimin e vetë 10-të vjeçar dhe për këtë qëllim u organizuan aktivitete 10-të ditore, përkatësisht trajnime plotësuese të trajnimeve të rregullta.¹

Akademia për Gjyqtarë dhe Prokurorë Publikë zbatoi trajnim në temë: “Dëshmimi konform Ligjit të ri për procedurë penale – përvojat e Kroacisë”, të dedikuar për përfaqësuesit e Këshillit të Prokurorëve Publikë, Këshillit Gjyqësor, gjyqtarët e seksioneve penale dhe për

¹ <http://www.jpacademy.gov.mk/novosti/---10---ee--ae----->



prokurorët publikë të juridiksioneve të gjykatave të apelit të Gostivarit dhe Shkupit, për përfaqësuesit e Ministrisë së Drejtësisë të Republikës së Maqedonisë dhe për avokatët.

Akademia, në bashkëpunim me Zyrën për Patenta dhe Marka Tregtare nga Danimarka, organizoi tre këshillime dyditore, me temë: “Mbrotjtja gjyqësore juridike – penale, Juridike-civile dhe Mbrotjtja gjyqësore administrative e të drejtave të pronësisë intelektuale”. Ngjarjet e fundit nga fusha në fjalë i prezantuan gjyqtarët e gjykatave supreme të Letonisë, Rumanisë, Italisë dhe Danimarkës, si dhe gjyqtarë të seksioneve të specializuara gjyqësore, prokurorë publikë, hetues dhe ekspertë nga Zyra për Patenta dhe Marka Tregtare e Danimarkës dhe nga Gjykata Tregtare. Këshillimet u dedikuan për gjyqtarë dhe prokurorë publikë të juridiksionit të Gjykatës së Apelit të Shkupit dhe Gostivarit, si dhe për gjyqtarë të Gjykatës së Lartë Administrative dhe Gjykatës Administrative, për përfaqësuesit e Entit Shtetëror të Pronësisë Industriale, për ekspertë, avokatë, përfaqësues të të drejtave të pronësisë industriale dhe për përfaqësues të institucioneve të tjera relevante.

Në vigjilje të zgjedhjeve të caktuara parlamentare, ndërkaq në bashkëpunim me Misionin e OSBE në Shkup, Akademia organizoi këshillim për ndryshimet e Kodit Zgjedhor për gjyqtarët e Gjykatës së Lartë Administrative dhe të Gjykatës Administrative, për përfaqësuesit e Komisionit Shtetëror të Zgjedhjeve, Komisionit Shtetëror për Parandalimin e Korrupsionit, Entin Shtetëror të Revizionit, si dhe për përfaqësuesit e Asociacionit Qytetar MOST.

Më datë 16.11.2016, Akademia, në bashkëpunim me OSBE mbajti Konferencë rajonale me titull: “Reduktimi i përdorimit të Internetit për qëllime terroriste”, në të cilën morën pjesë përfaqësuesit shtatëdhjetë gjyqtarë, prokurorë publikë dhe hetues nga 12 shtete të Evropës Juglindore.

Kodeksi i etikës gjyqësore për gjyqtarë në Maqedoni u prezantua në Shkup në organizim të Akademisë për Gjyqtarë dhe Prokurorë Publikë dhe Shoqatës së Gjyqtarëve të Republikës së Maqedonisë² Target grup i prezantimit ishin gjyqtarët dhe prokurorët publikë të juridiksionit të gjykatës së apelit të: Manastirit, Gostivarit, Shkupit dhe Shtipit, përfaqësuesit e Dhomës së Avokatisë të RM-së, Dhomës së Noterisë të RM-së, Dhomës së Përmbauesve të RM-së dhe organizatat joqeveritare.

Akademia organizoi këshillim me temë: “Administrimi me resurse njerëzore”, i cili u mbajt më datë 22 nëntor të vitit 2016. Këshillimi iu dedikua administratës gjyqësore nga të gjitha gjykatat në Republikën e Maqedonisë.

Më datë 24 nëntor të vitit 2016, Akademia organizoi konferencë rajonale dyditore “Përforcimi i bashkëpunimit midis institucioneve të jurisprudencës nga vendet e Ballkanit Perëndimor”, me qëllim të shkëmbimit të përvojave dhe përmirësimit të efikasitetit dhe cilësisë së trajnimeve. Në konferencë morën pjesë tetë drejtorë të akademive të jurisprudencës nga

² Kodeksi etik i gjyqtarëve në Maqedoni është miratuar në vitin 2014 dhe i njëjti parashikon trup këshillëdhënës në përputhje me rekomandimet e GREKO nga rrethi i 4 i vlerësimit i cili kërkon formimin e trupit këshillëdhënës, i cili do t'i këshillojë gjyqtarët në rastet kur kanë dilema etike. Ky Komitet etik nuk përcakton kurrfarë përgjegjësie disiplinore, por jep orientime ose rekomandime të cilat mund t'u ndihmojnë gjyqtarëve në punë dhe në miratimin e vendimeve. Shih: <http://www.akademik.mk/wp-content/uploads/2015/04/KodeksNaSudskaEtika13102014.pdf>

Evropa Juglindore dhe Turqia, përfaqësues nga Akademia për të Drejtën Evropiane (EPA) dhe programi HELP pranë Këshillit të Evropës, si dhe Sekretari i Përgjithshëm i Rrjetit Evropian për Trajnim në Jurisprudencë (EJTN).

Në bashkëpunim dhe me mbështetje financiare të Misionit të OSBE në Shkup, ndërkaq në drejtim të vazhdimit të implementimit të trajnimeve për zbatimin e LPP, Akademia për Gjyqtarë dhe Prokurorë Publikë organizoi trajnim me temë: “Roli i gjyqtarit/Etika dhe paanshmëria e gjyqtarit”.

Akademia për Gjyqtarë dhe Prokurorë Publikë në bashkëpunim me Ministrinë e Drejtësisë, ndërkaq në kuadër të Projektit Tuining të Letonisë dhe Kroacisë, më datë 28 dhe 29 nëntor të vitit 2016 organizoi dy trajnime njëditore për gjyqtarë, këshilltarë gjyqësorë, prokurorë dhe avokatë lidhur me zbatimin e nenit 10 të Konventës Evropiane për të Drejtat e Njeriut dhe praktikës gjyqësore të GJEDNJ.

Monitorimi i procedurave gjyqësore³

Gjatë muajit nëntor seanca kryesore për lëndën KOK nr. 60/16 në publik e njohur si “Puç”, më datë 01.11.2016 u shty pasi që kryetari i kolegjit gjyqësor, para të pranishmëve konstatoi se njëri nga gjyqtarët – porotë, sipas kërkesës së tij personale është shkarkuar nga kolegji, me ç’rast ishte caktuar gjyqtar-porotë i ri, si dhe gjyqtar-porotë plotësues, për të cilët krahas kërkesave dhe intervenimeve për emergjencë, të dërguara nga kryetari i gjykatës, akoma nuk u janë siguruar certifikata sigurie për veprim dhe këqyrje në informacionet dhe të dhënat e klasifikuara, e që janë të domosdoshme për gjyqtarët-porotë të sapo emëruar që të veprojnë sipas lëndëve konkrete.⁴

Trupi gjykues të cilit iu nda propozim akuza e Prokurorisë Publike për Ndjekjen e Veprave Penale të ndërlidhura dhe të cilat rezultojnë nga ndjekja e paligjshme e komunikacioneve (PSP) kundër 7 personave të pandehur për veprën penale, “Falsifikim të dokumentit zyrtar” caktoi seancë për datën 28.11.2016. Përndryshe, menjëherë pas paraqitjes së propozim-akuzës, PSP paraqiti edhe kërkesë për përjashtimin e gjyqtarit kompetent, ndërkaq kërkesa në afatin e përcaktuar ligjor u hodh poshtë nga kryetari i gjykatës, dhe pas kësaj PSP paraqiti ankesë deri te Gjykata e Apelit – Shkup, me ç’rast Gjykata refuzoi ta përjashtoj gjyqtarin. Së këtejmi, pas evitimit të të gjitha presupozimeve për caktimin e seancës, e njëjta u caktua në datën e lartpërmendur.⁵

Kolegji penal pranë Gjykatës Themelore Shkup 1 – Shkup duke vepruar sipas ankesës së PSP të paraqitur kundër aktvendimit të gjyqtarit të procedurës paraprake nga 28.10.2016 në lëndën e PSP të njohur si “Tenderët”, miratoi aktvendim me të cilin ankesa e prokurorisë hidhet poshtë, ndërsa konfirmohet aktvendimi i gjyqtarit të procedurës paraprake.⁶

³ Nga monitorimi i rregullt i procedurave gjyqësore të Koalicionit “Të Gjithë për Gjykim të Drejtë”

⁴ 01.11.2016 KOMUNIKATË, <http://osskopje1.mk/Novosti.aspx>

⁵ 04.11.2016 KOMUNIKATË, <http://osskopje1.mk/Novosti.aspx>

⁶ 07.11.2016 KOMUNIKATË, <http://osskopje1.mk/Novosti.aspx>

Seanca lidhur me lëndën K. nr. 1904/16 në lidhje me ngjarjet para Komunës Qendër, për të cilën diskutimi kryesor ishte caktuar për datën 21.11.2016 u shty për shkak të mungesës së mbrojtësit të M.J. - Nikolla Dodevski.⁷

Kolegji Penal i Seksionit për krim të organizuar dhe korrupsion pranë Gjykatës Themelore Shkup 1 Shkup, duke vepruar sipas ankesës së PSP kundër aktvendimit të gjyqtarit të procedurës paraprake të datës 04.11.2016 për përcaktimin e masave të kujdesit kundër tre personave të përfshirë në lëndën e cila në publik njihet si “Thesari” miratoi aktvendim me të cilin konfirmohet aktvendimi i gjyqtarit të procedurës paraprake dhe ankesa e PSP për përcaktimin e masave të kujdesit për të tre personat refuzohet si e pabazë.⁸

Këshilli Gjyqësor i RM

Këshilli Gjyqësor i Republikës së Maqedonisë, më datë 23.11.2016, i shqyrtoi dhe miratoi raportet e punës së gjykatave në Republikën e Maqedonisë për tremujorin e tretë të vitit 2016. Mori vendim për të kryer vlerësim të jashtëzakonshëm të kandidatëve për kryetarë të gjykatave. U shqyrtuan më shumë raporte, ndërkaq u miratua edhe vendimi për referim të përkohshëm (6 muaj) të gjyqtarit nga një gjykatë themelore në një gjykatë tjetër themelore. U angazhua që Komisioni kompetent të ndërmerr vendime dhe të kryej hetime lidhur me gjendjet në Gjykatën Themelore Shkup 1 Shkup dhe të hartoj raport.⁹ Duke vepruar sipas obligimit të vet, Komisioni i thërriti në takim gjyqtarët, nënshkrues të njoftimit të dërguar më datë 11.11.2016, në ambientet e Këshillit Gjyqësor më datë 28.11.2016 (e hënë).¹⁰

Kryetari i Këshillit Gjyqësor të Republikës së Maqedonisë, më datë 03.11.2016, realizoi takim me Ambasadorin e Britanisë së Madhe SH.T. Çarls Garet në të cilin u diskutua për reformat në sistemin e jurisprudencës dhe shkallën e realizimit të tyre.¹¹

Më datë 01 dhe 02 nëntor 2016, një delegacion i Këshillit Gjyqësor të RM-së, bashkë me përfaqësues të gjykatave dhe prokurorisë publike, morën pjesë në Konferencën Rajonale në Bukuresht, Rumani, me temë: “Parandalimi dhe lufta kundër korrupsionit në gjyqësor dhe prokurorinë publike në Evropën Juglindore”.¹²

Në periudhën nga data 16 deri më datë 18 nëntor 2016, në Budva – Mali i Zi në organizim të Ministrisë së Punëve të Jashtme të Norvegjisë dhe Administratës Gjyqësore të Norvegjisë, u mbajt edhe Konferenca e II-të Rajonale, me temë: Përmirësimi i sistemit të kuotës dhe evaluimit të punës së gjyqtarëve”. Në Konferencë morën pjesë përfaqësues të Këshillit Gjyqësor të Republikës së Maqedonisë, si dhe përfaqësues të Këshillave Gjyqësorë të rajonit: Sllovenia, Kroacia, Bosnja e Hercegovina, Shqipëria dhe Mali i Zi.¹³

Sa u përket deklaratave të kryetares së Gjykatës Supreme të Republikës së Maqedonisë, Lidija Nedellkova, në emisionin “360 shkallë” në TV Alsat-M, të datës 11.11.2016, Këshilli Gjyqësor i Republikës së Maqedonisë, lëshoi komunikatë në të cilën kategorikisht i hodhi

⁷ 17.11.2016 KOMUNIKATË, <http://osskopje1.mk/Novosti.aspx>

⁸ 22.11.2016 KOMUNIKATË, <http://osskopje1.mk/Novosti.aspx>

⁹ Komunikatë nga mbledhja e 239 e datës 23.11.2016, <http://www.ssrn.mk/Novosti.aspx?novost=476>

¹⁰ Komunikatë lidhur me gjendjen në Gjykatën Themelore Shkup 1 Shkup, <http://www.ssrn.mk/Novosti.aspx?novost=477>

¹¹ 07.11.2016 Komunikatë, <http://www.ssrn.mk/Novosti.aspx?novost=468>

¹² 11.11.2016 Komunikatë, <http://www.ssrn.mk/Novosti.aspx?novost=470>

¹³ 21.11.2016 Komunikatë, <http://www.ssrn.mk/Novosti.aspx?novost=475>

poshtë si të pavërteta pretendimet e Nedellkovës, e cila deklaroi se si anëtare e Këshillit Gjyqësor të Republikës së Maqedonisë sipas funksionit, nuk është ftuar me rregull në mbledhjet e caktuara dhe se qëllimisht mbledhjet janë caktuar në ditët kur ajo ka qenë në udhëtim jashtë Republikës së Maqedonisë.¹⁴

Më datë 15.11.2016, në ambientet e Këshillit Gjyqësor të RM-së është mbajtur prezantim dhe tryezë e rrumbullakët, me temë: “Si të transformohen të dhënat në njohuri të aplikueshme dhe efikase”. Lidhur me lëvizjen e lëndëve në vitet 2013, 2014 dhe 2015, nga eksperti Hoxhiq është hartuar raport sipas indikatorëve “shkalla e zgjidhjes së lëndëve dhe koha e zgjidhjes së lëndëve”, me ç’rast konstatohet se në nivel të të gjitha gjykatave të Republikës së Maqedonisë vërehet progres në kuptim të zvogëlimit të ditëve të nevojshme për zgjidhjen e një lënde, si dhe të rritjes së shkallës lëndëve të zgjidhura, përkatësisht përballimit të prurjes së lëndëve të reja dhe reduktimit të lëndëve të pazgjidhura të prapambetura, në kushte të zvogëlimit permanent të numrit të gjyqtarëve.

Përmirësimi i bashkëpunimit gjyqësor lidhur me qasjen e lirë në informacione, zbatimin e procedurave ndërkuftare dhe procedurës ndërkuftare të falimentimit, bashkëngjitjes dhe bashkimit

Më datë 28 nëntor të vitit 2016 u mbajt debat për politikat publike lidhur me bashkëpunimin gjyqësor për qasjen e lirë deri te informacionet, ekzekutimin ndërkuftar dhe procedurat ndërkuftare të falimentimit, bashkëngjitjes dhe bashkimit. Detajisht u trajtua realizimi i ndihmës juridike ndërkombëtare dhe problemet që paraqiten, ndërsa u theksuan edhe përvoja komparative. Njëherësh, u shqyrtuan shumë çështje që kanë të bëjnë me falimentimin, kështu që u identifikuan një sërë dobësish dhe mangësish në legjislacionin dhe praktikën. U shqyrtua edhe ekzekutimi ndërkuftar, si dhe roli i dhomave dhe shoqatave profesionale. Si rezultat nga diskutimi rezultuan më shumë rekomandime të qëndrueshme.

Mbështetje e ZAK: Inkorporimi ose përmirësimi i kornizës ligjore për ZAK dhe mundësimi i bashkëpunimit adekuat juridik dhe institucional me sistemin gjyqësor dhe sistemin për zbatimin e Ndërmjetësimit

Nga aspekti i promovimit të ndërmjetësimit si mënyrë për ZAK jashtë procedurës gjyqësore, në organizimin e Asociacionit për Mbështetje të Ndërmjetësimit pranë Dhomës Ekonomike të RM-së, u mbajtën disa seminare njëditore falas në: Veles, Gjevgjeli, Kumanovë, Tetovë dhe Strumicë me temën: “Ndërmjetësimi si mënyrë efikase e zgjidhjes së kontesteve.” Pjesëmarrës në këto seminare, para së gjithash ishin persona nga biznesi sektori, nga gjykatat, avokatët dhe përfaqësuesit e institucioneve shtetërore.

¹⁴ 15.11.2016 Komunikatë, <http://www.ssrn.mk/Novosti.aspx?novost=472>

Në sesionin e nëntorit të provimeve për dhënien e provimit për ndërmjetësues në Ministrinë e Drejtësisë, nga 21 kandidatët fillimisht të interesuar dhe të paraqitur, të cilët u paraqitën për dhënien e provimit, vetëm 9 prej tyre e kaluan me sukses pjesën e parë (pyetjet e provimit) dhe pjesën e dytë të provimit (studime të rasteve). Pjesa e tretë e provimit (intervista) nuk është mbajtur akoma. Procedurën e ndërmjetësimit ende në mënyrë aktive e zbatojnë vetëm nëntë ndërmjetësuesit e licencuar.

Gjatë muajit nëntor janë adaptuar tri zyra për nevojat e ndërmjetësimit në gjykatat themelore: Kavadar, Vinicë dhe Shkup 2, ndërkohë që gjykatat ende e kanë obligimin që ta publikojnë listën e ndërmjetësuesve të licencuar në tabelën e njoftimeve të gjykatave.

Zgjidhja paqësore e kontesteve të punës

Në muajin nëntor shënohet rritje e numrit të personave të cilët interesohen për zgjidhjen e çështjeve të kontesteve të punës në MPPS, megjithatë nuk paraqesin as kontest individual e as kolektiv. Asociacioni i Pajtuesve dhe Arbitrave për Konteste të Punës në Republikën e Maqedonisë (APAKP) regjistroi domenin www.apars.mk, ndërsa u realizua edhe plotësimi i kësaj ueb-faqe me pasqyrën e objektivave të APAKP, informatat themelore për kontestet e punës, si dhe informatat e aktiviteteve të APAKP në periudhën rrjedhëse. Gjithashtu, janë në rrjedhë aktivitetet me qëllim të botimit të një libri me abstrakte dhe përmbledhjes së punimeve nga konferenca e pajtuesve dhe arbitrave të kontesteve të punës, e cila u mbajt në muajin tetor të vitit 2016 në Ohër.¹⁵

¹⁵ Asociacioni i Pajtuesve dhe Arbitrave për Konteste të Punës në Republikën e Maqedonisë